



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 14

Prishtinë, më 17.7.2013, në orën 11.00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj – Beqaj,
Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Kimete Bytyçi dhe Duda Balje.

Munguan: Justina Pula dhe Kymete Bajraktari.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Sulltane Gashi - zyrtare ligjore dhe Burim Tahiri,
mbështetës i Komisionit-UNICEF.

Pjesëmarrës të tjerë: Nuredin Ibishi-UNDP, Ervin Ibrahim-UNDP, Floriana Shala-
OSBE, Elita Vokshi-OSBE, Sakibe Jashari-Ambasada Zvicerane, Ukë Gashi-ZPRK dhe
Gjylberije Zabeli-praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25 qershor 2013;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit për mbikëqyrjen e Ligjit për barazi gjinore;
4. Shqyrtimi i informatave të kërkuara nga ministritë;
5. Shqyrtimi i raportit kundër trafikimit me qenie njerëzore për vitin 2012;
6. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja propozoi që të hiqet pika e pestë e rendit të ditës, në mungesë të deputetes Kymete Bajraktari, pasi që ajo ka qenë e interesuar për shqyrtimin e këtij raporti.

Rendi i ditës u miratua me këtë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25 qershor 2013

Kryetarja- Konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 25 qershor 2013, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit për mbikëqyrjen e Ligjit për barazi gjinore

Kryetarja –Fillimisht, tha se tani kemi raportin e kompletuar për monitorimin e Ligjit për barazi gjinore dhe bëri një rezymë të këtij raporti. Ajo tha se raporti është i njëjtë me herën e kaluar, përveç asaj që e kemi zgjeruar me të dhëna edhe nga disa ministri.

Duke elaboruar punën e grupit punues, tha se në fillim të raportit kemi kompetencat e Komisionit, në bazë të secilit është kryer monitorimi. Po ashtu, kemi pasur Raportin e progresit, i cili na ka obliguar që ta bëjmë monitorimin e këtij ligji. Gjithashtu, kemi bërë hartimin e planit për mbikëqyrjen e këtij ligji, organizimin e vizitave në terren, hartimin dhe dërgimin e pyetësorëve, kemi marrë disa të dhëna nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, është bërë organizimi i seancave dëgjimore, dhe si rezultat i gjithë këtyre punëve, është përgatitur ky raport ku i kemi bashkangjitur edhe materialet përcjellëse, si pyetësorët, listat e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese dhe jo- bashkëpunuese, si dhe dy transkriptet e dëgjimeve publike.

Kryetarja bëri prezantimin e strukturës së përfaqësimit të strukturës gjinore nëpër të gjitha institucionet, të cilat kanë dërguar përgjigjet në pyetësor në formë të tabelave. Ajo tha se sektori i mediave dhe shoqëria civile nuk është përgjigjur në pyetësor. Nga partitë politike kemi marrë përgjigje nga Lëvizja Vetëvendosje, nga partia Demokratike Turke e Kosovës dhe nga Partia Rome.

Ajo prezantoi edhe 15 rekomandimet që kanë dalë si rezultat i të gjeturave gjatë monitorimit të këtij ligji, ku pozita përfaqësuese e femrës është më mirë në nivelin qendror se sa në atë lokal.

Kurtan Kajtazi-Tha se kërkesa që ai kishte për zgjerimin e pyetësorëve nëpër dikastere tjera, në ministri, në nivelin lokal, ka dhënë rezultate dhe është një ndryshim për të mirë dhe po vjen duke u zbatuar ky ligj, mirëpo nuk është ende e mirë pozita e femrës në pozita vendimmarrëse. Unë kam dyshim sa i përket numrit 50%, është vështirë për t'u realizuar, sepse dihet realiteti si është. Vlen të theksohet se nuk është fare e drejtë nëse diku janë të punësuar 200 persona dhe 50 janë femra, atëherë si të bëhet 50%, a të largohen meshkujt nga puna? Këtu duhet të kemi kujdes se çka po vendosim, sepse na

kushton në të ardhmen, sepse ligji duhet të zbatohet. Ai dha propozim që punësimi dhe përfaqësimi gjinor të jetë në mënyrë të barabartë dhe mos të përmenden shifra.

Kryetarja-Tha se ligji duhet të respektohet dhe kjo vlen për të ardhmen. Po ashtu, duhet të plotësohen kriteret. Unë po flas në bazë të statistikave të regjistrimit të popullsisë, ku i kemi 49% me 51%, atëherë për këtë 40% është diskriminues.

Duda Balje-Tha se në Dragash struktura e femrave është më e vogël, sepse femrat nuk lajmërohen në konkurse. Unë po flas nga situata të cilën e kam parë dhe duhet të gjendet një mes për këtë.

Kimete Bytyçi-Tha se nuk po e kupton punën e pagesave sa i përket pushimit.

Kryetarja- Tha se femrat, për shkak se kanë për t'u martuar dhe për të lindur, dhe për këtë iu takon pushimi i lehonisë, merren më me vështirësi në punë. Sipas saj, për këtë po u jepet përparësi meshkujve.

Kryetarja- Tha se fillimisht po e qesim në votim propozimin e anëtarit të Komisionit, Kurtan Kajtazi, që te rekomandimi i parë, të hiqet pika 1.1 dhe 1.6.

Kryetarja- Konstatoi se për propozimin që të hiqen pikat 1.1 dhe 1.6, është vetëm një votë për dhe 6 kundër, pastaj u votua për raportin me rekomandime në tërësi, ndërsa për këtë u konstatua se janë të gjithë për, përveç anëtarit Kurtan Kajtazi, i cili ishte që rekomandimit të parë, t'i hiqen pikat 1.1 dhe 1.6.

Përfundim

Komisioni, unanimisht, votoi raportin e monitorimit të Ligjit për barazi gjinore dhe vendosi që i njëjti të procedohet për miratim në seancën e Kuvendit të Kosovës.

4. Shqyrtimi i informatave të kërkuara nga ministrinë

Kryetarja- Tha se kemi disa informata prej disa ministrive që na kanë informuar për disa lëmi. Po ashtu, kemi informatën nga Zyra e Komisionarit për Gjuhët, në lidhje me respektimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Me këtë informatë njoftohemi se Zyra e Komisionarit për Gjuhët, ka filluar aktivitet për monitorimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Konkluzioni i këtij raporti është dorëzuar në të gjitha ministrinë dhe në Kryesinë e Kuvendit të Kosovës dhe se shumica e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore, nuk zbatojnë detyrimet sipas ligjit.

Ajo tha se për këtë rast duhet t'i kemi edhe disa informacione nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, sepse ata janë duke monitoruar këtë ligj dhe nuk kemi njoftim a ka përfunduar monitorimi.

Biserka Kostiq-Tha se monitorimi ka filluar dhe mendon se raporti ende nuk ka përfunduar. Më tej, tha se ka pasur debat publik për këtë, ndërsa me sa di, tani ka vizita në terren ku po kërkohen informata lidhur me zbatimin e këtij ligji. Zyra në kuadër të

Kryeministrisë, ende nuk është kompletuar e gjitha, ende nuk është kompletuar stafi. Më është thënë se një grua që ka qenë e punësuar aty më herët, asnjëherë nuk e ka marrë parasysh asnjë ankesë dhe askush nuk ka marrë përgjigje nga ajo zyrtare. Po ashtu, nuk ka të dhëna deri ku kanë shkuar ankesat e paraqitura. Ajo tha se në zyrën e saj i ka shkresat, sa herë që është ankuar dhe asnjëherë nuk ka marrë përgjigje.

Kryetarja- Tha se Komisioni duhet t' i drejtohet me një shkresë Komisionit për të Drejtat e Komuniteteve dhe Kthim, që të na njoftojë zyrtarisht me rrjedhën e monitorimit të ligjit.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

Përfundim

Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, kërkon nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, që të informohet lidhur me monitorimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, me rrjedhën dhe procedurën e monitorimit, në cilën fazë është dhe a ka përfunduar ende raportin.

Kryetarja-Tha se informata tjetër është nga Ministria e Arsimit, lidhur me implementimin e kurrikulës në gjuhës rome, braktisjen e shkollimit nga ana e nxënësve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Ministria informon se ka hartuar plan programin e gjuhës rome, me elemente të historisë dhe kulturës, si lëndë zgjedhore. Kjo lëndë mësohet dy orë në javë. MASHT- i ka botuar plan-programin e gjuhës rome, me elemente të kulturës dhe historisë në tri gjuhë: në gjuhën shqipe, rome dhe në gjuhën serbe. Është akredituar dhe realizuar programi i Këshillit të Evropës: “Qasja në arsimin cilësor i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian”, si dhe “Programi trajnues për mësimdhënien e mirëkuptimit ndërkulturor”. Në tetor të vitit 2011, mësimi i gjuhës rome ka filluar në Prizren me nxënës të klasës së 2- të, të shkollës fillore, ku janë përfshirë 94 nxënës të komunitetit rom. Këtë vit shkollor (2012/2013), vazhdon me klasën e 2-të dhe klasën e 3-të, në bashkëpunim me DKA-në në Prizren. Nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, kanë qasje të barabarta në sistemin e arsimit në Kosovë. Janë organizuar kurset kundër analfabetizmit, posaçërisht për vajza dhe gra. Si rezultat i këtyre aktiviteteve dhe angazhimeve të lartpërmendura nga ana e MASHT-it, është zvogëluar dukshëm braktisja e shkollës.

Kryetarja-Sipas kësaj informate, shihet se Ministria e Arsimit është duke punuar për t'i mbajtur në shkollim komunitet.

Kimete Bytyçi-Tha se sa i përket ndarjes së bursave, nuk është cekur se a ndahen për nxënësit e shkëlqyeshëm apo vetëm që është minoritet dhe nuk është cekur numri i nxënësve që braktisin shkollat.

Kryetarja-Tha se bursat ndahen për komunitetin RAE, por natyrisht merret për bazë suksesi.

Albana Gashi- Pajtohet me atë se në raport mungon e dhëna sa i përket numrit të nxënësve që braktisin shkollat dhe është një raport vetëm sa për t'u përgjigjur, ku thuhet se në të gjitha shkollat, nxënësit e komuniteteve mësojnë me nxënës tjerë. Këtë e kemi parë dhe jemi të informuar se si është situata.

Kryetarja-Tha se mund të kërkojmë plotësim të kësaj informate, pra numrin e saktë të braktisjes së shkollave nga nxënësit e komuniteteve dhe në cilën fazë të shkollimit ka më shumë braktisje të shkollave nga nxënësit, në shkollën fillore apo të mesme.

Kimete Bytyçi- Propozoi që të kërkohej edhe informatë, se a bëhet braktisja e shkollës në fillim, në gjysmë apo në fund të gjysmëvjetorit shkollor.

Rita Hajzeraj-Beqaj-Tha se duhet kërkuar edhe informatën se çka ka ndërmarrë Ministria e Arsimit lidhur me atë se fëmijët po kanë shumë tekste, sidomos prej klasës së parë deri në klasën e pestë. Kur kanë qenë përfaqësuesit e Ministrisë prezent në Komision, kanë premtuar se në shtator ose do të bëjnë zvogëlimin e sfondit të teksteve, ose do të krijojnë hapësira në shkolla për libra. Lidhur me këtë, të na njoftojnë se çka është ndërmarrë për këtë vit.

Komisioni, pas debatit nxori këtë

Përfundim

Kërkohej nga Ministria e Arsimit që të bëjë informatë shtesë lidhur me numrin e nxënësve të komuniteteve që braktisin shkollën, në cilën fazë të shkollimit ka më shumë braktisje të shkollës nga nxënësit, në shkollën fillore apo të mesme, si dhe a bëhet braktisja në fillim, në gjysmë apo në fund të gjysmëvjetorit shkollor.

Gjithashtu, Ministria ka premtuar se këtë shtator ose do të bëjë zvogëlimin e sfondit të teksteve, sepse nxënësit janë shumë të ngarkuar për moshën që e kanë, ose do të krijojnë nëpër shkolla hapësira për libra, të na njoftojnë se çka është ndërmarrë lidhur me këtë për fillimin e vitit të ri shkollor.

Kryetarja-Tha se tani kemi informatën e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ku njoftohemi për riintegrimin e personave të riatdhesuar. Lidhur me këtë, në këtë informatë thuhet se gjatë shtatorit 2012, deri në qershor 2013, janë kthyer 2861 persona, prej tyre 2136 janë kthyer me dhunë dhe 730 janë kthyer vullnetarisht. Prej tyre, 393 janë femra dhe 2468 meshkuj. Sipas nacionalitetit, 1802 janë shqiptarë, 444 romë, 231 ashkali, 153 goranë, 137 boshnjakë, 93 serbë, 12 turq dhe 7 egjiptianë. Po ashtu, kemi të dhëna edhe sa i përket shërbimeve që u janë ofruar këtyre personave. Janë dhënë informata për funksionalizimin e departamentit dhe informata për profilin e personave të riatdhesuar.

Kryetarja- Kemi edhe informatën e Ministrisë së Kthimit dhe Komuniteteve, se çka është ndërmarrë lidhur me riintegrimin dhe stabilizimin e komuniteteve. Është një raport që ka përshkruar situatën, por nuk është një raport konkret. Në këtë raport flitet për krijimin e bazës ligjore për një shoqëri demokratike, rolin e Ministrisë në procesin e

kthimit, ngritjen e vetëdijes për nevojat më të mëdha për fonde dhe stabilizimi i komuniteteve përmes implementimit të projekteve të Ministrisë dhe rritja e numrit të kthimit të qëndrueshëm.

Duda Balje- Tha se duhet të kërkohet thjesht një statistikë, sa shtëpi janë ndërtuar për secilin komunitet në dy vitet e fundit, sepse po thuhet që është viti 2013, por neve na duhen informatat për secilin komunitet.

Kryetarja- Propozoi që të kërkohen informata shpesh se sa familje janë kthyer për secilin komunitet, sa shtëpi janë ndërtuar për secilin komunitet, sa familje janë akomoduar, të tregohet se çka është bërë për familjet e secilit komunitet.

Komisioni, pas debatit , nxori këtë

Përfundim

Kërkohen informata shpesh nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, që të njoftojë Komisionin lidhur me numrin e familjeve të kthyer për secilin komunitet, numrin e shtëpive të ndërtuara për secilin komunitet, sa familje janë akomoduar, të tregohet se çka është ndërmarrë për familjet e kthyer të secilit komunitet.

Kryetarja- Tha se informatën e fundit e kemi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale rreth përpilimit të politikave të ndryshme për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, ku na kanë njoftuar për ligjet ekzistuese, udhëzimet administrative që i kanë nxjerrë, të cilat rregullojnë fushën e personave me aftësi të kufizuara, ligje që ne i dimë. Ndërsa, sa i përket Ligjit nr. 2011/04-L-092 për personat e verbër, kryetarja tha se tani ne si Komision, do të bëjë monitorimin e zbatimit të këtij ligji.

7. Të ndryshme

Albana Gashi- Informoi rreth monitorimit të Ligjit për personat e zhdukur, si dhe njoftoi për pyetësorët të cilët janë shpërndarë. Ajo tha se kryetari i Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur ka refuzuar të përgjigjet, për arsye se pyetjet janë politike. Po ashtu, ajo tha se ka vështirësi lidhur me shpërndarjen e pyetësorit në shoqatën e të zhdukurve serb.

Kurtan Kajtazi-Tha se nuk është i informuar me pyetësorin dhe se duhet që grupi punues të bëjë strategjinë për monitorimin e këtij ligji. Duhet ta hartojmë pyetësorin, sepse unë nuk jam ftuar në mbledhje të grupit punues dhe se ftesat dhe materiali të bëhet nga stafi i Komisionit, e jo individualisht nga anëtarët e Komisionit.

Biserka Kostiq- Tha se asnjëherë nuk ka qenë e informuar për mbajtjen e mbledhjes së grupit punues dhe se nuk e di kush është hartues i pyetësorit, dhe se ajo nuk mund që individualisht ta dërgojë pyetësorin nëpër familje të të zhdukurve serbë. Kjo është e vështirë, pasi që nuk ka të regjistruar në Kosovë një shoqatë të familjarëve serbë të personave të zhdukur. Ajo tha se është e interesuar që këtij monitorimi t'i bashkohet edhe

deputetja Jasmina Zhivković, pasi që këtë e lejon Rregullorja e Kuvendit, sepse mund të marrë pjesë edhe një anëtar jashtë komisionit, por pa të drejtë vote, ndërsa për këtë e kam njoftuar edhe kryetaren e Komisionit.

Kryetarja- Tha se është mirë që të bëhet plani i veprimit për monitorimin e këtij ligji, dhe përmes administratës së Komisionit, të njoftohen të gjithë anëtarët e këtij grupi punues, si dhe Jasmina Zhivković. Lidhur me këto të dhëna, sa i përket familjarëve të të zhdokurve serbë, mund të kontaktohet Komisioni Qeveritar për Personat të Pagjetur, sepse ata i kanë të dhënat edhe për shoqatat nga komuniteti serb.

Sa i përket mospërgjigjes në pyetësor, tha se më ka kontaktuar kryetari i Komisionit Qeveritar për Persona të Pagjetur dhe më ka thënë se nuk mund të përgjigjet, sepse pyetësi ka përmbajtje politike, ndërsa ka kërkuar nga ai që të përgjigjet në pyetjet që mendon se nuk kanë përmbajtje politike, por nuk di më shumë se a është përgjigjur në pyetjet tjera.

Komisioni vendosi që të martën, më 23 korrik, të bëjë një vizitë në burgun e Dubravës, nisja do të bëhet nga Kuvendi, në orën 10.00.

Po ashtu, u vendos që të mërkurën, më 24 korrik, pas mbledhjes, të vizitohet Qendra e Shëndetit Mendor në Shtime.

Mbledhja përfundoi në orën 12:50.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali